




ARKEP

AUTORITETI RREGULLATIV I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
REGULATORNI AUTORITET ZA ELEKTRONSKE I POŠTANSKE KOMUNIKACIJE
REGULATORY AUTHORITY OF ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS



Nr. Prot. 010/B/21

VENDIM Nr. 1686

Për

Miratimin e

'Rregullores për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës'

Në mbështetje të nenit 1, nenit 3, paragrafi 1), nenit 9 paragrafi 3.6), nenit 10, paragrafët 4), 11) dhe 12), nenet 45-54, neneve 58 - 61 dhe nenit 79, paragrafët 1) dhe 2), të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si - Ligji ose LKE*); në referim të nenit 13, paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si - Autoriteti ose ARKEP*), Bordi i Autoritetit i përbërë nga,

- 1) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 2) z. Hazir Hajdaraj, Anëtar
- 3) z. Nijazi Ademaj, Anëtar

në mbledhjen e 61-të me radhë të mbajtur më datë 01 Mars 2021, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet 'Rregullorja për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës' së bashku me dokumentin 'Konkluzione nga Konsultimi Publik i Dokumentit'.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Ligji, respektivisht neni 10, paragrafët 4) përcakton se Autoriteti: "Miraton legjisllacionin sekondar lidhur me këtë ligj, të cilat janë në kompetencë të Autoritetit, mbështetur në dispozitat e këtij ligji."

Më tutje, neni 10, paragrafët 11) dhe 12) të Ligjit përkufizojnë kompetencat e Autoritetit për miratimin e Planit Kombëtar të Numeracionit dhe menaxhimin e resurseve numerike në komunikimet elektronike.

Faqe 1 nga 2

B.A.

Neni 82 i Ligjit përkufizon se Autoriteti gjatë aprovimit të akteve normative duhet t'i publikoj ato në pajtim me kushtet dhe procedurat e vendosura nga Autoriteti, duke ua ofruar mundësinë personave të interesuar që në afat të arsyeshëm kohor të shprehin pikëpamjet e tyre.

ARKEP me Vendimin nr.1666 (Ref. Nr.Prot.069/B/20) ka miratuar fillimin e procesit të konsultimit publik të Draft Rregullores për Planin Kombëtar të Numeracionit për Rrjetet e Komunikimeve Elektronike në Republikën e Kosovës, e cili ka zgjatur nga data 29 Dhjetor 2020 deri më datë 28 Janar 2021.

Pas shqyrtimit të komenteve të operatorëve të pranuar gjatë procesit të konsultimit publik, ARKEP ka miratur Rregulloren së bashku me konkluzionet, përkatësisht qëndrimet e ARKEP ndaj komenteve të operatorëve.

Andaj, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 10/03/2021

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare



Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamentit Ligjor (DL),
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike (DKE),
- Arkivës së Autoritetit.